



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

RELACION TEKNIK

(KONTRATA NR.14)

Mirembajtje me performance rruga: "**Peshkopi (K/Rr.Tomin)-D/Kuben- Vasije, U. Çerenecit – Sebisht (Borovë)**"

Përshkrim i përgjithshëm.

Aksi rrugor **“Peshkopi – Vasije” 36.9 km**, është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër. Aksi rrugor fillon ne dalje te qytetit Peshkopi, (ish SMT degezimi rrugaTomin), dhe mbaron ne kufi me Kukësin (Fshati Vasije). Gjendja e rruges eshte e mire dhe pse ky segment rrugor eshte rikonstruktuar nga FZSHH kohet e fundit dhe vazhdon te mirembahet me kontrate mirembajtje , por si rezultat i kushteve atmosferike ka bere qe ne disa vende te kemi cedime ne trup te rruges si dhe shembje te trupit te rruges duke u demtuar vazhdimesia e rruges ne disa vende pergjate gjatesise se saj. Per rehabilitimin e aksit rrugor, eshte nderhyre nga ARRSH per sinjalistiken dhe nderhyrje ne vende te demtuara. Ne kemi parashikuar punime ne ato vende qe nuk jane parashikuar per nderhyrje nga sa u permend me siper duke kontaktuar me kontraktorin qe miremban dhe kontraktoret qe nderhyjn ne sinjalistike dhe vendet e demtuara. Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh qytetin e Kukësit, Kosovën me Qarkun Diber, Maqedoninë e Veriut etj. Segmenti klasifikohet i kategorisë C si rrugë interurbane dytësore , me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens). Rruga ka gjerësi karrexhate 6.0 ml te asfaltuar dhe me bankina 2x0.5ml. Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një terren të theksuar malor, i cili përfshihet në të gjithë gjatësinë e tij si segment me mirëmbajtje dimërore.

Aksi rrugor **“Ura e Çerenecit-Sebisht (Borove), (20.4 km)**, është segment rrugor qe pritet te behet pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër. Aksi rrugor: ”Ura Çerenecit – Sebisht (Borove), eshte pjese e aksit rrugor nacional: ”Ura Çerenecit – Librazhd” , Gjurma e re qe fillon ne kryqezimin e rruges “Bulqize-Peshkopi (Ura Çerenecit) dhe mbaron ne fshatin Sebisht (Borove).. Aksi rrugor: **“Ure Çerenecit-Sebisht (Borove)**, ka nje gjatesi 20.4 km, kalon ne terrene teper malore, ka parametra teknik me normat e reja te projektimit, eshte nje rruge dy kalimshe, karrexhata e saj aktualisht eshte





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

teresisht e shtruar me çakull gurorë. Segmenti klasifikohet i kategorisë C si rrugë interurbane dytësore , me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens), Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një terren të theksuar malor, i cili përfshihet në të gjithë gjatësinë e tij si segment me mirëmbajtje dimërore. Ky aks rrugor aktualisht është duke u rehabilituar nga fondi shqiptar i zhvillimit.

Duke u nisur nga kjo nuk kemi parashikuar punime rehabilitimi, pasi është rruge e re dhe me ganci punimesh.

Me poshte paraqiten ne forme tabelare segmentet rrugore qe perbejne kete kontrate

Nr.	Segmenti rrugor	Gjatësia (km)	KOORDINATA E PIKES SE FILLIMIT (WGS 84)		KOORDINATA E PIKES SE MBARIMIT (WGS 84)	
			N	E	N	E
1	Peshkopi (D/Rruga Tomin) - D/Kuben	2.2	41°41'17.7"	20°25'13.7"	41°41'44.8"	20°23'55.8"
2	D/Kuben - Vasije	34.7	41°41'44.8"	20°23'55.8"	41°51'44.0"	20°25'59.1"
3	Ura e Çerenecit - Sebisht (Borovë)	20.4	41°31'15.3"	20°25'04.6"	41°23'33.7"	20°25'11.2"
Shuma (km):		57.3				

Kushtet e inspektimit.

Sot me datë 29.03.2024, në zbatim të Urdhërit të Brëndshëm Nr.113 datë 26.03.2024, kemi bërë inspektimin në terren të segmenteve rrugore "**Peshkopi (K/Rr.Tomin)-D/Kuben-Vasije, U. Cerenecit – Sebisht (Borovë)**". Bazuar në urdhërin e brëndshëm për përlllogaritjen e fondit limit, si objektivi i inspektimit tonë ka qënë konstatimi i gjëndjes aktuale të segmenteve rrugore në fjalë dhe përcaktimi i nevojave për punime rehabilitimi që do ketë ky segment gjatë 4 viteve të ardhshme (2025-2029) , me qëllim hartimin e preventivave për përlllogaritjen e fondit limit të kontratës së ardhshme. Theksojmë se inspektimi jonë është vetëm i karakterit vizual.

Përshkrimi i situatës aktuale të segmenteve rrugore .

Gjëndja e akseve rrugore "**Peshkopi (K/Rr.Tomin)-D/Kuben- Vasije**" është mesatare në përgjithësi me disa problematika që vijnë edhe si pasojë degradimit të disa elemnteve rrugorë që favorizohen nga relievi i vështirë malor dhe nga kushtet ekstreme atmosferike.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

Gjatë zbatimit të kontratës së mëparshme të mirëmbajtjes vihet re një ndërhyrje kryesisht në riparime të pjesshme të shtresave asfaltike të përqendruara më shumë në segmentin vendosje të barrierave mbrojtëse etj. Por duke u nisur nga fakti se aksi rrugor kalon nëpër një terren të theksuar malor, dhe çdo vit përballet me kushte të vështira atmosferike, vërehet së aksi ka nevoja të metëjshme në shtimin apo përmirësimin e të gjithë elementeve të rruges për rritjen e sigurisë rrugore dhe shtimin e jetegjatesisë së rruges nga dëmtimet që vijnë si pasojë e mos trajtimit të problematikave si dhe lehtësimin e përdoruesve të rruges që përdorin këto aks rrugor, pjesë të cilën do ta trajtojmë më hollësisht në pikat e mëposhtme.

Evidentimi i problematikave dhe propozimi për zgjidhjen e tyre.

• Segmenti rrugor **"Peshkopi (K/Rr.Tomin)-D/Kuben- Vasije"** është segment i plotësuar kryesisht me sinjalistikë vertikale dhe horizontale. Rezulton se momentalisht është ndërhyrë pjesërisht në përmirësimin e shtresave rrugore. Shtresat asfaltike të rrugës janë në gjendje të mire dhe vende të ndryshme të dëmtuara. Konkretisht si më poshtë:

Ne km 0.3;0.5 nevojitet skarifikim dhe shtrese asfaltobetoni në gjatësi 100 ml, në km 1.0;1.1;1.3;1.4;1.8 nevojiten skarifikim dhe shtrese asfaltobetoni në gjatësi 480 ml, në km 3.9, riparim mur guri (Ura e Borovjanit) me gjatësi 12x 1.0 m² seksion, vendosje guardrails 30 ml, në km 4.0 (Ura e Sohodollit) vendosje guardrails 30 ml, km 5.8, shkolla fshati Kastriot, nevojitet vijezim pranë hyrjes së shkollës. Në km 7.5 të (Ura) 60 ml guardrails, km 9.3 vendosje bordura betoni 100 ml, km 10.0, ndertim dhe riparim mur guri prites 30 ml x 2m² seksion, vendosje guardrails 100 ml, km 11.7 ndertim dhe riparim mur guri prites 35 ml x 2m² seksion, vendosje guardrails 80 ml km 12.1 vendosje bordura betoni 100 ml, km 12.6 ana e majte vendosje guardrails 80 ml, km 13.4;15.0;16.1;17.8;21,8 vendosje bordura betoni 500 ml, km 22.1;22.6 vendosje tombino ø800, skarifikim dhe shtrese asfaltobetoni 30 ml, km 23.1, cedim,ndertim mur mbajtes betoni 40 ml x 2m² seksion, shtresa dhe nenshtresa 50 ml, vendosje bordura betoni 50 ml, km 23.3, ndertim mur guri prites me volum 8ml x 1.5m² seksion, km 26.7 ndertim mur prites betoni me volum 80 ml x 2m² seksion, rrafshim skarpate 120 m², skarifikim, shtres asfaltobetoni 80 ml, km 27,2 ndertim mur guri me volum 12 ml x 1.5 m² seksion, 50 ml nenshtresa, shtres asfaltobetoni 60 ml skarifikim dhe shtres asfaltobetoni, km 27.6 skarifikim dhe shtres asfaltobetoni 100 ml, km 29.5 vijezim me boje(Shkolla Ujemire), km 30.9, cedim, vendosje tombino ø 800, 20 ml nenshtres dhe shtrese asfaltike, km 31.1, nenshtres dhe shtresa asfaltike 100 ml(Ceren), km 32.3;32.5 skarifikim dhe shtres asfaltobetoni 150 ml, km 34.7 nenshtres dhe shtres





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

asfaltobetoni 50 ml, km 35.8, nenshtres dhe shtres asfaltobetoni 30 ml, km 36.1 nenshtres dhe shtres asfaltobetoni 50 ml,(Vasije).

Volumet e punimeve te tjera jane paraqitur te fragmentarizuara ne segmente prej 1km ne tabelat e shperndarjes se punimeve.

Te gjithë pjesët që do riveshen janë llogaritur te behen edhe vijezimët.

Gjatë gjithë gjatësisë së segmenteve janë parashikuar dhe riparime të tjera të vogla të mureve mbajtjes dhe pritës apo brezave te betonit, punime të cilat evidentohen në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit.

Parashikimi i punimeve të rehabilitimit.

Për të lehtësuar mënyrën e paraqitjes së shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit, kemi menduar që sasitë e këtyre punimeve ti paraqesim fragmentuara dhe të grupuara në segmente prej 1 kilometri. Përzgjedhja e zërave të punimeve të rehabilitimit është bërë në bazën e eksperiencës që kemi në kontratat e mëparshme duke evidentuar zërat që kanë rezultuar me efektivitet me te lartë gjatë kontratave të shkuara, si dhe shtimin e disa zërave te rinj të cilët na kanë rezultuar të duhur për përdorim në situata të caktuara.

Volumet e punimeve të parashikuara për një periudhë 4 vjeçare sipas segmenteve respektive, janë paraqitur në tabelat e shpërndarjes se punimeve te rehabilituse periodike.

Tabela përmbledhëse e kategorisë së punimeve të rehabilitimit është :

Nr.Ana	Përshkrimi I punimit	Njesia	Sasia
	1. PUNIME GERMIMI		
3.119/a	Germim shkambi i coptuar me ekskavator 0.5 m ³ , shkemb, ne themele gjeresi ~2 m, me shkarkim ne toke,	m3	120
3.95/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m3	85



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3.158/3a	Transport dheu me auto deri 3.0 km	m3	205
3.161/2	Rrafshim skarpate ne germim,ekskavator 0.25m3	m2	200
	2. PUNIME SHITESASH		
3. 197	Prishje shtrese çakelli t = 10 cm, me makineri	m2	3000
3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	3000
3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2	3000
3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	3000
3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	5220
3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	35
	3. ANALIZA TEKNIKE		
3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri	m2	3000
3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	7620
	4. PUNIME BETONI E BETONARMEJE		
3. 244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	160
3. 235	Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 20% gur	m3	60
	5. PUNIME HEKUR BETONI 3		
3. 287	F V hekur betoni i zakonshem \varnothing 6 ~ 10mm	ton	1.21
3. 288	F V hekur betoni i zakonshem \varnothing > 12mm	ton	2.1
	6. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT +KANALIZIME		
3. 323	Mur guri mbajtes e themele, Ilaç çimento M50	m3	252
3. 396	Mbushje me cakell pas mureve	m3	150



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3. 332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m3	105
3. 405	Prishje struktura prej guri	m3	35
3. 366	Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni	ml	24
	7. PUNIME TE NDRYSHME		
3. 618	FV Bordura betoni 20x35 cm	ml	750
	8. D. SINJALET DHE PAJISJET SHTESE, NGADALSUESIT E SHPEJTESISE		
3.948/1	F.v.kurrize artificiale h =5cm	copë	12
3.949/1	Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm	ml	5600
3. 953	FV tabela rrugore treguese 150x40cm	copë	12
3. 955	FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm	copë	85
	11. TE NDRYSHME ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA		
3.921/1	F.v. Tabele katrore normal me A=60	copë	32
3.936/1	F.v. Tabela trekendore normal me A = 90	copë	24
3.935/1	F.v. Tabele rrethi "ndalim" normal me D = 60	copë	24
3.933/1	F.v. Tabela tetekendore normal me A-B, 90-30	copë	8
3.941/1	F.v. Pervijues normal anesor	copë	120
3.941/3	F.v. Pervijues modulare te kthesave (teke)	copë	38
3.941/4	F.v. Pervijues modulare te kthesave (qyfte)	copë	34
3.941/5	F.v. Pervijues kthese e ngushte ose e forte(ne forme T)	copë	30
3.186	F.V guardrail- H1 anesore me 2 valz.e ne 1 ane , W3	ml	230



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3. 165	Fuge me gome speciale me kanal te gjere ne ura	ml	12
--------	--	----	----

Foto nga inspektimi në terren.

Gjatë inspektimit në terren janë fotografuar dhe disa nga problematikat aktuale të akseve rrugore. Bashkangjitur ketij relacioni jane edhe fotot dhe tabelat e shperndarjes se punimeve te rehabilituse periodike :

GRUPI I PUNËS :

